



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

# STRATEGJIA 2018-2023

# I. Vizioni dhe misioni i FTI

---

## *I.1. Vizioni*

Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit (FTI) si njësi kryesore në Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT) synon përsosjen e formimit inxhinierik dhe shkencor në fushën e Teknologjisë së Informacionit, Inxhinierisë Informatike, Inxhinierisë së Elektronikës dhe Telekomunikacionit, për përgatitjen e specialistëve të lartë, të aftë për të projektuar, prodhuar dhe menaxhuar në fushat përkatëse si dhe në zgjidhjen e problemeve teknike sa më komplekse në vënd dhe jashtë tij.

## *I.2. Misioni*

FTI mundëson formim të thelluar shkencor për ushtrimin e iniciativave dhe aftësive vendim-marrëse në situata komplekse dhe të paparashikueshme, për të punuar në projektimin, integrimin, dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektronike dhe të Telekomunikacionit, duke i imlementuar ato në laboratoret shkencore të SI (Sisteme të Informacionit) për prodhim industrial. Prgatitja e specialistëve në këto fusha ka për qëllim punësimin e tyre si inxhinierë në projektimin, realizimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të telekomunikacionit, sistemeve elektronike dhe sistemeve komplekse të informacionit në fushën e sistemeve inteligjente; menaxhimin e teknologjive të komunikimit dhe të protokolleve të transmetimit të dhënave.

FTI përhap njohuri, rrit dijet, duke u mundësuar studenteve:

1. të fitojnë njohuri të thella në aspektet metodologjike dhe aplikative të matematikës dhe shkencave të tjera bazë të Inxhinierisë së Elektronikës dhe Telekomunikacionit dhe të jenë në gjendje të përdorin këto njohuri për të interpretuar problemet që dalin në këto fusha.
2. të krijojnë, të transmetojnë, të zhvillojnë e të mbrojnë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve si edhe të formojnë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në fushën e inxhinierisë informatike.
3. të njohin në përgjithësi dhe në thellësi fushat e inxhinierisë Informatike, Elektronike dhe Telekomunikacionit në të cilat të jenë gjendje të identifikojnë, formulojnë dhe zgjidhin problemet duke përdorur metoda, teknika dhe paisje bashkëkohore.
4. të formojnë aftësitë e nevojshme për të punuar në projektim, vënie në jetë dhe mirëmbajtje të sistemeve informatike, elektronike dhe të telekomunikacionit, menaxhimin e teknologjive të komunikimit dhe të protokolleve të transmetimit të dhënave.
5. të fitojnë aftësi dhe mjete intelektuale për të planifikuar dhe udhëhequr procese kërkimi inovative të mirëfillta apo të zbatuara.
6. të jenë të aftë të kryejnë eksperimente dhe të analizojnë dhe interpretojnë të dhënat e marra prej tyre.

7. të fitojnë aftësi në përdorimin e mjeteve dhe metodologjive në mënyrë që të bëjnë të mundur trajtimin e proceseve industriale dhe planifikimin e zgjidhjeve në sferën e sistemeve reale.
8. të njohin përgjegjësitë e veta profesionale dhe etike.
9. të fitojnë aftësi për organizimin, administrimin dhe aspektet ekonomike të ndërmarrjeve.
10. të fitojnë aftësi vendimmarrëse dhe komunikimi.
11. të kenë mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë (studimet doktorate) në inxhinieri informatike, elektronike dhe telekomunikacioni apo në fusha të afërta me të.
12. të venë në provë njohuritë e grumbulluara dhe aftësitë inxhinierike dhe të komunikimit në fusha tipike si, rinovimi dhe zhvillimi i prodhimit, planifikimi i thellë, menaxhimi i sistemeve komplekse si specialist i pavarur i punësuar në ndërmarrje/organizata publike apo private.

## II. Ndërkombëtarizimi i FTI

---

### *II.1. Synimet e ndërkombëtarizimit të FTI janë:*

1. Rritja e njohjes ndërkombëtare diplomave të FTI.
2. Rritja e veprimtarisë ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor, nëpërmjet pjesëmarrjes në programet dhe projektet kërkimore kombëtare, Evropiane dhe rajonale dhe më gjerë.
3. Zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkëmbimit të personelit akademik në të gjitha ciklet e formimit.
4. Promovimi i formimeve dhe diplomave të përbashkëta me institucione homologe ndërkombëtare, kryesisht të ciklit të dytë dhe të tretë duke i dhënë në këtë mënyrë një vlerë të shtuar formimit dhe titujve universitarë të ciklit të parë, të lëshuar nga UPT.

## III. Menaxhimi institucional i FTI

---

### *III.1. Zhvillimi i qendrushëm të kapaciteteve njerëzore, financiare dhe infrastrukturore*

FTI bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale në dispozicion të njësisë.

#### *III.1.1. Zhvillimi i Qendrushëm i Kapaciteteve Njerëzore (ZH.Q.K.NJ.)*

III.1.1.1. FTI ka si objektiv të pajisë studentët më njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor në fushën e Inxhinierisë Informatike, Elektronike dhe të Telekomunikacionit.

FTI me personelin e akademik të brendshëm, stafin ndihmës dhe stafin akademik të ftuar, siguron zhvillimin e procesit mësimor dhe të punës kërkimore- shkencore në departament.

III.1.1.2. FTI i konsideron me rëndësi jetike burimet njerëzore cilësore në të gjithë veprimtaritë e tij akademike. Synon të përmirësojë politikat e rekrutimit të personelit akademik, duke:

1. rekrutuar personel akademik me arritje të spikatura në fushën e informatikes,
2. krijuar një mjedis tërheqës dhe krijues për personelin e ri akademik,
3. maksimizuar arritjet e personelit të tij akademik,
4. garantuar mundësi të barabarta për zhvillimin e karrierës së personelit akademik,
5. nxitur komunikimin për të gjithë personelin duke zhvilluar “praktikat më të mira”.

#### *III.1.2. Zhvillimi i Qëndrueshëm i Kapaciteteve Financiare ( ZH.Q.K.F.)*

Burimet e financimit të FTI vijnë nga dy drejtime kryesore: Granti i akorduar nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e krijuara nga njësitë kryesore (fakultetet dhe institutet). FTI krijon të ardhura nga disa burime:

- tarifat e shkollimit të studentëve
- të ardhurat nga projektet
- të ardhura nga shërbimet për studentët (vërtetime, lëshim dokumentacioni, etj)
- të ardhura nga shërbimet për të tretët.

FTI synon të realizojë objektivat e tij, në këtë fushë si vijon:

1. rritja e autonomisë në politikën e menaxhimit;
2. rritja e të ardhurave të UPT nëpërmjet veprimtarive në fushat e tij të ekspertizës.

FTI ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve.

#### *III.1.3. Zhvillimi i Qëndrueshëm i Kapaciteteve Infrastrukturore ( ZH.Q.K.I.)*

FTI zhvillon aktivitetin e tij në mjediset e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në një godinë të re. Në dispozicion të FTI ka zyra, laboratore dhe auditorë për zhvillimin e mësimin.

FTI për ZH.Q.K.I. synon :

1. menaxhimin efikas të mjediseve të tij;
2. zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës bibliotekare
3. zhvillimin e qëndrueshëm të bazës laboratorike dhe pajisja e tyre me teknologjitë moderne të informacionit;
4. përmbushjen e standardeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit dhe mbrojtjes së mjedisit;
5. përmirësimin e shërbimeve për studentët dhe personelin e tij.

## IV. Menaxhimi i procesit të mësimdhënies në FTI

---

### *IV.1. FTI synon përmirësimin e kulturës së cilësisë në procesin e edukimit nëpërmjet zbatimit të standarteve më bashkekohore*

FTI zbaton mekanizma për promovimin dhe zotërimin e një kulture të cilësisë, zhvillimin e procedurave për monitorimin dhe rishikimin e cilësisë akademike dhe rritjen e saj në të gjitha programet e studimit ku kontribuon.

### *IV.2. Reformimi në bazë të rezultateve të të mësuarit dhe me qendër studentin*

FTI I duke u mbështetur në traditën e programeve të studimit të ofruara dhe në zhvillimet më të fundit, do të bëjë të gjitha përpjekjet për modernizimin dhe zhvillimin e programeve të studimit në të tre ciklet, që ai ofron, mbi bazën e dy shtyllave kryesore:

1. Vendosi të studentit në qendër të mësimin. 2. Zhvillimit të programeve të studimit në bazë të rezultateve të të mësuarit ("Learning Outcomes" - LO), konform kërkesave të zhvillimit të UPT, vendit dhe atyre Evropiane.

Në procesin e zhvillimit të qendrueshmën kurrikular, FTI do të krijojë mundësi të barabarta në mësim dhe vlerësim për të gjithë studentët duke synuar zhvillimin e të gjithë potencialit të tyre. Ai do të forcojë monitorimin e progresit akademik të çdo studenti.

Grupet mësimore-kërkimore të çdo departamenti do të punojnë së bashku për nxitjen e metodave moderne dhe efektive të zhvillimit të lëndëve që të japin rezultate optimale për studentët.

FTI do të zhvillojë në mënyrë të qendrueshme, në bashkëpunim me "Allumni" dhe biznesin e fushës së tij të ekspertizës, shtojcën e diplomave, që ajo lëshon në mënyrë që të diplomuarit e tij të integrohen sa më mirë dhe më shpejt në tregun e punës.

### *IV.3. Vlerësimi periodik i programeve të studimit dhe akreditimi i tyre*

Akreditimi dhe rankimi i programeve të studimit, që ofron FTI, duke synuar që ato të jenë lider në Shqipëri dhe të krahasueshëm në rajon dhe më gjerë.

Për plotësimin e këtij objektivi në FTI do të synohet:

1. Forcimi i rolit të "Alumni"-it dhe i biznesit në përmirësimin e programeve të studimit në fushën e Inxhinierisë Informatike, Elektronike dhe Telekomunikacioni;
2. Konsultimi i studimit të tregut për përmirësimin e objektivave formuese të programeve të studimit, duke i orientuar ato drejt rezultateve të të nxënimit në përputhje me Kornizën Shqiptare dhe Evropiane të Kualifikimeve;

3. Përmirësimi i procesit të informimit të studentëve dhe personelit të FTI-së me informacion të përditësuar, në kohë reale;
4. Përmirësimi i procesit të orientimit të studentëve dhe këshillimit akademik të tyre.

#### *IV.4. Rritja e cilësisë në praktika profesionale dhe diversifikimi i tyre*

FTI synon zhvillimin e aftësive praktike të studentëve. Nëpërmjet marrëveshjeve me kompani dhe biznese që operojnë në fushën e Informatikës, Elektronikës dhe Telekomunikacionit, studentët kryejnë praktikat si pjesë e procesit mesimor. FTI nxit dhe mbështet krijimtarinë e studentëve.

#### *IV.5. Zhvillimi i infrastrukturës dixhitale për përmirësimin e edukimit dhe krijimin e oportuniteteve për personelin akademik*

FTI synon zhvillimin e qendrueshëm të metodave dhe metodikave në mësimdhënie duke u mbështetur në teknologjitë e reja të komunikimit dhe zhvillimit dhe u krijuar të gjitha mundësitë personelit akademik për të përshtatur dhe për t'u zhvilluar në përputhje me to. FTI thekson përdorimin e infrastrukturës së IT në të gjithë veprimtarinë e tij duke mbështetur përpjekjet për zhvillimin e infrastrukturës dixhitale në shërbim të mësimin me pikësnyim rritjen e përdorimit të sistemeve dhe teknologjive për zhvillim profesional të personelit akademik dhe të studentëve.

#### *IV.6. Zhvillimi i qendrueshëm i cilësisë në FTI*

FTI krahas përmirësimit të vazhdueshëm të mesimdhënies vlerëson dhe synon të realizojë hapjen e programeve të reja të studimit në drejtime specifike në fushat e Informatikës, Elektronikës, Telekomunikacionit, Sigurisë së Informacionit. Nëpërmjet vendosjes së kriterëve specifike të pranimit seleksionon studentët me karakteristikat më të mira.

#### *IV.7. Fuqizimi i nismave mbështetëse për të ndihmuar suksesin profesional dhe futjen e të diplomuarve në tregun e punës*

FTI synon të mbështesë:

1. monitorimin e vazhdueshëm të tregut të punës;
2. organizimin i moduleve të veçanta për forcimin e aftësive dhe të njohurive të studentëve për të lehtësuar futjen e studentëve në tregun e punës;
3. nismat që çojnë në lehtësimin e punësimit të studentëve;
4. organizimin e panairëve të punës për inkurajimin e kontakteve punëdhënës-punëmarrës.

## V. Menaxhimi i kërkimit shkencor në FTI

---

### *V.1. Zhvillimi i burimeve njerëzore, i kapaciteteve infrastrukturore dhe financiare në shërbim të kërkimit shkencor dhe shërbimeve në FTI*

Për plotësimin e këtij objektivi synohet:

1. ruajtja dhe zhvillimi i burimeve njerëzore për të garantuar vazhdueshmërinë e kërkimit shkencor në FTI;
2. rritja e fondeve për kërkimin shkencor dhe shërbimet;
3. përmirësimi i infrastrukturës së kërkimit shkencor;
4. kontributi në forcimin e bibliotekave shkencore të UPT.

### *V.2. Rritja në sasi dhe cilësi e veprimtarisë kërkimore dhe e shërbimeve në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.*

Për plotësimin e këtij objektivi synohet:

1. bashkëpunimi me institucionet publike dhe organizmat qeveritare me qëllim kontributin për trajtimin e problematikës që lidhen me zhvillimin perspektiv të vendit për përbalimin e sfidave në drejtim të një zhvillimi të qëndrueshëm;
2. fuqizimi i kapaciteteve krijuese të personelit akademik e kërkimor të FTI nëpërmjet inkurajimit të lirisë kërkimore për të adresuar çështje me rëndësi shkencore në shërbim të zhvillimit të vendit;
3. zhvillimi i kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar në fushën e informatikës;
4. zhvillimi i një klime bashkëpunimi me institucione të tjera publike dhe private brenda vendit që operojnë në fushat përkatëse inxhinierike;
5. bashkëpunimi me sektorin privat për të mundësuar dhënien e ekspertizës dhe zgjidhjen e probleme teknike e teknologjike që hasen;
6. zhvillimi i kërkimit shkencor në FTI në përputhje me standartet e cilësisë.

### *V.3. Rritja e kontributit të kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike në ciklet e studimit*

Për plotësimin e këtij objektivi synohet kontributi në:

1. thellimin e integritit të kërkimit shkencor me mësimdhënien nëpërmjet angazhimit të studentëve në projekte studimore e kërkimore me qëllim kultivimin tek këta të fundit të shprehive të kërkuesit e studjuesit të integruar në grup si dhe të ofrimit të kapaciteteve cilësore laboratorike dhe të vëzhgimit e eksperimentimit në terren;
2. sigurimin dhe promovimin e lidhjeve të vazhdueshme me institucionet dhe universitetet homologe Evropiane dhe më gjerë përmes bashkëpunimit dhe projekteve të përbashkëta në fushat me interes të përbashkët në shërbim të kualifikimit shkencor dhe shkëmbimi i eksperiencave në këto fusha;
3. përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, për të kontribuar në formimin e tyre profesional, rritjen e shkallës së përvetësimit të programeve mësimore, orientimin e tyre në tregun e punës, iniciimin e tyre si kërkues të ardhshëm si dhe për të realizuar objektivat e kërkimit.

### *V.5. Evidentimi dhe përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar që zhvillohet në FTI*

Për plotësimin e këtij objektivi synohet:

1. një administrim më i mirë i kërkimit shkencor nëpërmjet krijimit të bazave të të dhënave dixhitale, lehtësisht të përdorshme dhe inventarizim më të mirë të pasurive shkencore të FTI-ë;
2. bërja publike të të gjithë projekteve të financuara, në kuadrin e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim zhvillimit për një shfrytëzim sa më të gjerë të informacionit shkencor;
3. publikimi i rezultateve të kërkimit shkencor në revista të njohura si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

*V.6. Rritja e kontributit të kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe ekspertizës në fushat përkatëse inxhinierike në sigurimin e të ardhurave suplementare për FTI.*

Për plotësimin e këtij objektivi synohet:

1. pjesëmarrje aktive në projektet e financuara nga AKKSHI;
2. krijimi i të ardhurave nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
3. një pjesëmarrje më e gjerë në ekspertiza e konsulencë, duke i konsideruar si elementë jo vetëm të afirmimit profesional e shkencor.

## VI. Menaxhimi i jetës studentore në FTI

---

*VI.1 Përmirësimi i cilësisë së jetës studentore duke synuar rritjen e cilësisë së shërbimeve si dhe zbatimin e një politike gjithpërfshirëse si në vendimarrje ashtu dhe në zhvillimin shoqëror për studentët*

*VI.1.1 Përmirësimi dhe rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve, duke krijuar një kulturë shërbimi cilësor bashkohor, që synon:*

1. përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve nëpërmjet informimit, këshillimit, mbështetjes si dhe orientimit të tyre;
2. kontributin në krijimin dhe përmirësimin e një infrastrukture të përshtashme dhe funksionale në shërbim të studentëve.

*VI.1.2 Përmirësimi dhe zbatimi i një politikë gjithpërfshirëse si në vendimarrje ashtu edhe në zhvillimin e veprimtarisë shoqërore nëpërmjet:*



1. përmirësimin dhe rritjen e rolit të studentëve në proceset e vendimmarrjes,
2. përmirësimin të politikës gjithëpërfshirëse të zhvillimit shoqëror, për studentët.

#### *VI.2 Përmirësimi i cilësisë së sistemit të menaxhimit të informacionit në nivel institucional*

FTI angazhohet për kontributin në përmirësimin e cilësisë së sistemit të menaxhimit të informacionit në nivel institucional, duke synuar paraqitje të plotë, të qartë, të saktë e të përditësuar të informacionit për studentët që lidhet me veprimtarinë e FTI, veçanërisht me procesin mësimor. Mirëfunksionimi i sistemit të menaxhimit të informacionit në nivel institucional u mundëson studentëve kontaktin me tutorin, për të garantuar të drejtat e tyre dhe monitorimin e problemeve të mundshme.

#### *VI.4 Përmirësimi dhe zbatimi i një politikë gjithëpërfshirëse si në vendimarrje ashtu edhe në zhvillimin e veprimtarisë shoqërore*

##### *VI.4.1 FTI angazhohet për përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve në proceset e vendimmarrjes, mbështetjet në veprimtarinë e Këshillave Studentore fokusuar në objektivin parësor atë të përmirësimin të cilësisë në FTI*

Për plotësimin e këtij objektivi do të synohet:

1. kontributi në riorganizimin e Këshillave Studentore;
2. kontributi në krijimin e infrastrukturës së përshtatshme për Këshillat Studentore, në mjediset e njësive kryesore.

##### *VI.4.2. Përmirësimi i politikës gjithëpërfshirëse të zhvillimit shoqëror, për studentët.*

FTI është e angazhuar për kontributin në përmirësimin dhe zbatimin e një politike gjithëpërfshirëse të zhvillimit shoqëror për studentët, e cila synon në rritjen e veprimtarive shoqërore të studentëve jashtë auditorëve, duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë të jetës universitare.

Për plotësimin e këtij objektivi në FTI do të synohet:

1. Përmirësimi dhe rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve nëpërmjet informimit, këshillimit, mbështetjes si dhe orientimit të tyre;
2. Përmirësimi i cilësisë së sistemit të menaxhimit të informacionit, duke kontribuar në nivel FTI;
3. Përmirësimi dhe rritja e rolit të studentëve në proceset e vendimmarrjes në FTI.

Strategjia e FTI miratohet me datë **18.06.2018** dhe hyn në fuqi menjëherë.